



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:042572

Datë: 13.06.2024

Numri i dokumentit: 05870796

Ac.nr.6841/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Lumni Sallauka dhe Besnik Feka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëseve V.A. dhe Sh.A., nga Mitrovica, të cilat sipas autorizimit i përfaqëson A.B., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës - Drejtoria për Arsim, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L.Z., avokat në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensim i shujtës ditore, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Divizioni Civil, C.nr.242/2021, të datës 07.06.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 13.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Mitrovicës - Drejtoria për Arsim, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Divizioni Civil, C.nr.242/2021, i datës 07.06.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Divizioni Civil, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.242/2021, të datës 07.06.2022, ka vendosur si në vijim: “I. APROVOHET kërkesë padia e paditëseve V.A. dhe Sh.A. nga Mitrovica, si E BAZUAR. II. OBLIGOHET e paditura Komuna e Mitrovicës – Drejtoria për Arsim të paguaj – Paditëses V.A. në emër të kompensimit të shujtës ditore për 384 ditë pune të realizuara në periudhën prej datës 02.09.2019 deri me datë 31.05.2022, shumën prej 786 € dhe – Paditëses Sh.A. në emër të shujtës ditore për 326 ditë pune të realizuara në periudhën prej datës 02.09.2019 deri me datë 31.05.2022, shumën prej 652 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. III. OBLIGOHET e paditura që paditëseve në emër të shpenzimeve kontestimore, ti kompensoj shumën prej 378,80 €, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm”.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura përmes përfaqësuesit të autorizuar, në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e të paditurës, ndërsa aktgjykimin C.nr.242/2021, të datës 07.06.2022 ta anulojë dhe çështjen të e kthej në rigjykim dhe rivendosje pranë të njëjtës gjykatë.

Paditëset nuk kanë paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditëset, përmes të autorizuarit të tyre, kundër të paditurës kanë parashtruar padi me datën 05.03.2021, për pagës në emër të shujtës ditore, të cilën e kanë precizuar në seancën përgatitore të datës 07.06.2022, në raport me lartësinë e saj, duke kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija ashtu që të detyrohet e paditura që paditëseve t'ua paguaj shumat si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar dhe duke theksuar se heqin dorë nga pagesa e interesi ligjor, por kërkojnë pagesën e shpenzimeve të procedurës kontestimore. E paditura, me anë të përgjigjes në padi, ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësve, duke propozuar që e njëjta të refuzohet për shkak të mungesës së legjitimitetit.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave, ka marrë aktgjykimin e atakuar C.nr.242/2021, datë 07.06.2022, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar së nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vërtetimet e lëshuara nga SHFMU "Migjeni" në Mitrovicë, është vërtetuar se paditëset janë në marrëdhënie pune të ky institucion i arsimit, si dhe që paditësja V.A. gjatë periudhës 02.09.2019 deri me 19.01.2021 ka realizuar 188 ditë punë dhe nga data 22.01.2021 deri me datën 31.05.2022 ka realizuar 196 ditë pune, ndërsa paditësja Sh.A. gjatë periudhës 02.09.2019 deri me 19.02.2021 ka realizuar 129 ditë pune dhe nga data 22.01.2021 deri me datën 31.05.2022 ka realizuar 197 ditë pune. Gjykata e shkallës së parë thekson se ka vepruar konform nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sipas të cilit për një ditë të pranisë në punë njihet shuma 2.00 €, ashtu që paditësja V.A. për 384 ditë prani në punë gjatë periudhave të lartcekura x 2.00 € i ka njohur kompensimin në shumën 768 €, ndërsa paditësja Sh.A. për 326 ditë prani në punë gjatë periudhave të lartcekura x 2.00 € i ka njohur kompensimin në shumën 652 €. Ndërkaq, pretendimin e palës së paditur për mungesë të legjitimitetit pasiv të Komunës së Mitrovicës e vlerësoi si pretendim që nuk qëndron, me arsyetimin se institucionet arsimore në gjithë territorin e Komunës së Mitrovicës janë pjesë përbërëse e tij. Nga këto arsye gjykata ka vendosur që të aprovojë kërkesëpadinë dhe të obligojë të paditurën që paditëseve t'iu kompensojë shumat e përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata ka arsyetuar se ka vendosur konform nenit 452.1 të LPK-së, meqë paditëse kanë pasur sukses në këtë kontest.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat pretendon pala ankuese. Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe arsyetimi përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka paraqitur arsye mjaftueshme për shumat e aprovuara në emër të kompensimit të ushqimit për ditët e prezencës në punë.

Nuk qëndrojnë as pretendimet ankimore të paditurës se gjykata e shkallës së parë ka bërë zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, sepse në bazë të nenit 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi me datën 18.04.2017, përcaktohet se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. Në mënyrë të njëjtë këtë çështje e ka rregulluar edhe Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.prot.105, e datës 22.01.2021, me hyrjen në fuqi të secilës është shfuqizuar Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.01B/2056, e datës 18.04.2017, ku në nenin 35 par. 7 ka përcaktuar së *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore...”*. Në rastin konkret, duke pasur parasysh se nga gjendja faktike e vërtetuar rezulton se paditëset kanë realizuar ditët e punës siç janë të theksua më lart, gjë që është vërtetuar sipas vërtetimeve të lëshuara nga Shkolla Fillore e Mesme të Ulët “Migjeni” në Mitrovicë, ndërsa e paditura nuk u ka ofruar paditëseve ushqimin gjatë punës përmes restorantit, kuzhinës apo në ndonjë formë tjetër, atëherë mbi bazën e të lartcekurave, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëseve si të bazuar, duke ia njohur shumat përkatëse të kompensimit për ushqimin gjatë ditëve të pranisë në punë secilës paditëse veç e veç si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, andaj edhe vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Sa i përket pretendimit të së paditurës së e njëjta nuk ka legjitimitet dhe nuk ka obligim ndaj paditëseve pasi që nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, Gjykata e Apelit, gjeti së ky pretendim është i pabazuar, pasi që në bazë të nenit 90 paragraf 1 të Ligjit NR.03/L-212 të Punës është paraparë se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Sipas paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: 2.1. nivel të vendit, 2.2. nivel të degës, 2.3. nivel të ndërmarrjes”*. Ndërsa në bazë të nenit 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila është nënshkruar nga MASHT-it dhe SBASHK, është paraparë se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat- DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”*. Duke qenë së e paditura në këtë rast është punëdhënës i paditëseve, Gjykata e Apelit vlerëson së e njëjta ka për obligim që t’ua bëjë kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë, ndërsa koordinimi në mes të nivelit qendror dhe lokal në drejtim të alokimit të mjeteve për këtë kategori të pagesave që buron nga Kontrata Kolektive është çështje e brendshme e të paditurës me nivelin qendror dhe kjo assesi nuk mund të afekton në të drejtën e paditësve dhe detyrimin e të paditurës.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo konsideroi se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim nenin 452.1 të LPK-së.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS–PRISHTINË

Ac.nr.6841/2022, më datë 13.06.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari
Hysni Bardheci